



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/753  
Datë: 4/10/2017

Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"

**Korrigjim**

*i konkursit të shpallur më datën 28 Shtator 2017, për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2017/2018*

Në tekstin e konkursit bazik Nr. 2/677 të publikuar në ueb-faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës me datë 28.9.2017, janë përvjedhur disa gabime teknike tek kushtet specifike për pranim të studentëve në programet e Fakulteti Filozofik.

Prandaj teksti final i konkursit pas tabelës 1. Fakultetit Filozofik, teksti duhet të jetë si në vijim:

***Programi Integrimet Evropiane dhe Administratë Publike***

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në shkenca politike apo shkenca humanitare/sociale, diplomë dhe certifikatë të notave;
- Të kalojnë provimin pranues për integrimet evropiane (në temat: E drejta evropiane, Institucionet dhe vendimmarrja e BE-së, Politikat e UE-së, Integrimi ekonomik evropian dhe administratë publike) në gjuhë angleze, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

***Programi Politikë Ndërkombëtare***

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në shkenca politike apo shkenca humanitare/sociale, diplomë dhe certifikatë të notave;
- Të kenë dëshmi për nivelin e zotërimit të gjuhës angleze;
- Ta kalojnë me sukses provimin pranues. Testi pranues përmban pyetje nga fusha e shkencës politike, politikës, së drejtës dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare.

***Programi Psikologji shkollore dhe këshillimi***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore dhe gjuha angleze;

***Programi Sociologji***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e sociologjisë, shkencave sociale apo humanistike;
- Kandidati/ja duhet të ofrojë dëshmi (certifikatë ose diplomë) për njohjen e një gjuhe të huaj (botërore);
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha angleze;
- Nëse kandidati/ja e njej gjuhën frënge ose gjermane, verifikimi i njohurive do të bëhet përmes intervistës në këto gjuhë.

***Programi Histori e Kohës së Re***

T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e historisë;

- T'i nënshtrohen testimi lidhur me njohuritë profesionale nga studimet themelore;
- Të sigurojnë dëshmi për njohjen e një gjuhe të huaj, me preferencë gjuhën angleze.

***Programi Filozofi***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e filozofisë, shkencave sociale apo humanistike;
- Njohja e një gjuhe të huaj;
- Suksesi në provimin pranues.

Respekt,

Esat Klumendi,

Sekretari përgjithshëm i UP-së

